



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10<sup>1</sup> të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 184/13, 13/14, 44/14 , 101/14, 132/14, 142/16, 132/17 , 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21 dhe 154/23), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe nenin 104 paragrafi (4) të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-249 datë 18.7.2023 dhe Propozimin PA1 nr. 08-249, datë 31.7.2023, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-2966/3 të datës 1.8.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 25-të mbajtur më 1.8.2023, miratoi:

**Aktvendim**  
**për ndalim të procedurës së inicuar për heqje**  
**të lejes për transmetim në radio**

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, nr 08-437 datë 15.8.2016.

**A r s y e t i m**

Këshilli i Agjencisë në seancën e 23-të të mbajtur më 19.7.2023, me Konkluzion ark.nr.02-2865/2 të datës 20.7.2023, miratoi propozimin e drejtorit të Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, PA1 nr.08-249 datë 18.7.2023 dhe ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, nr 08-437 datë 15.8.2016, pasi që pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark. nr 05-2864/1, datë 17.7.2023, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë (lëshuar) nga Agjencia, nuk e ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht nuk ka paguar tarifën (kompensimin) vjetore për lejen e transmetimit në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Në këtë drejtim, nga Agjencia më datë 20.7.2023 drejtuar transmetuesit të lartpërmendur i është dërguar Shkresë PA1 nr.08-249, datë 20.7.2023, për ta njoftuar se nëse nuk paguan tarifën vjetore për lejen e transmetimit në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 31.7.2023, drejtuar Drejtorit të Agjencisë/personit të autorizuar për zëvendësim (në pajtim me autorizimin ark. nr. 03-2639/1, datë 27.6.2023), nga ana e Sektorit për financa dhe logjistikë, ishte dorëzuar Njoftim me nr.ark.05-2864/2 datë 31.7.2023, se SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, më 28.7.2023 ka bërë pagesën në shumë prej 21.020,00 ( njëzet e një mijë e njëzet denarë), me të cilën transmetuesi tarifën (kompensimin) vjetor për lejen e transmetimit në radio e ka paguar në tërësi.

PA1 Nr. 08-249

Shkup 03.08.2023.



Agjencia për  
shërbime mediatike  
audio dhe  
audiovizuele

rr. Makedonija nr 38  
1000 Shkup  
Republika e  
Maqedonisë së Veriut

tel. + 389 2 3103 400

[www.avmu.org.mk](http://www.avmu.org.mk)  
[www.avmu.mk](http://www.avmu.mk)  
[contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk)





**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

---

Rrjedhimisht nga sa më sipër, bazuar në nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) të ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 08-249 datë 18.7.2023 dhe Propozimin PA1 nr. 08-249, datë 31.7.2023, dhe sipas Konkluzionit ark.nr. 02-2966/3 datë 1.8. 2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 25-të mbajtur më 1.8.2023, vendosi ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike**  
**Audio dhe Audiovizuele,**  
**Kryetari i Këshillit**  
**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike :** Kundër këtij vendimi transmetuesi mund të paraqesë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

---

<sup>1</sup> Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë , shih: Neni 8 i Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 248/18).